



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:438/26 Datë: 03.04.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 147 të mbajtur më 23.03.2026, mori:

V E N D I M

- I. Nuk Riakreditohet në nivel Institucional Kolegji Iliria në Prishtinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

I. Shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

AKA pas kalimit të afatit të përcaktuar ligjor për dorëzimin e komenteve lidhur me draft raportin e ekipit të ekspertëve të jashtëm, të njëjtin draft raport e ka kthyer përsëri tek ekipi përkatës i ekspertëve. Ekipi i ekspertëve të jashtëm të akreditimit ka dërguar raportin final lidhur me procesin e zhvilluar për riakreditimin e Kolegjit Iliria. Sipas raportit përfundimtar të ekipit të ekspertëve pas rishqyrtimit të raportit dhe rekomandimeve të dhëna konsiston fakti se Kolegji Iliria nuk i plotëson kriteret ligjore për riakreditim prandaj dhe organi vendimmarrës Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) i AKA vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

- Rishqyrtimi i raportit të vitit 2019;

Pas rishikimit të raportit, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se, citim nga shkresa e ekspertëve: *Paneli ka shqyrtuar komentet e paraqitura nga Kolegji Iliria, datë 07.04.2025. Paneli ka përcaktuar se komentet nuk identifikojnë ndonjë gabim faktik brenda draft-raportit, siç përmendet në Manualin e Akreditimit të AKA-së në fuqi në vitin 2019 (faqet 42 dhe 46), si dhe Standardin 2.6 të Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG). Në fakt, komentet nuk trajtojnë aspak përmbajtjen e raportit, por çështje të tjera që lidhen me procesin e akreditimit. Sipas përgjegjësisë të përcaktuara në Manualin e Akreditimit të AKA-së në fuqi në vitin 2019 (faqja 45), nuk është në fushëveprimin e ekspertëve të shprehen mbi çështjet e ngritura nga Kolegji Iliria në përgjigjen e tij. Prandaj, paneli arrin në përfundimin se nuk kërkohen ndryshime në draft-raport. Prandaj, raporti mbetet i pandryshuar dhe do t'i paraqitet AKA-KShC.*

Veprimet procedurale nga AKA

Me datën 31.10.2018 Kolegji Iliria ka aplikuar për Riakreditim Institucional ne AKA. AKA ka angazhuar ekipin e ekspertëve për vlerësim të Kolegjit për procesin e riakreditimit në nivel institucional. Me datën 17 maj 2019 është organizuar vizita e vlerësimit në Kolegjin ILIRIA me ekspertët ndërkombëtar. Draft raporti i eksperteve ndërkombëtar është dorëzuar me datën 01.07.2019 në AKA me rekomandim qe Kolegji ILIRIA nuk i ka plotësuar kriteret për ri akreditim institucional. Kolegjit Iliria i është dërguar draft raporti me date 08.07.2019 për dhënien e komenteve.

Raporti përfundimtar i eksperteve është dorëzuar në AKA me datë 14.07.2019 me rekomandimin që Kolegji ILIRIA nuk riakreditohet në nivel institucional.

KShC në mbledhjen e 74 -të të datës 15.07.2019, me vendim Ref.1365/19D datë 29.07.2019 kishte vendosur që të mos Riakreditohet në nivel institucional Kolegji Iliria.

Kolegji ILIRIA i pakënaqur me vendimin e KShC-së ka ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave në AKA. Duke qenë se Komisioni i Ankesave në atë kohë ishte jo funksional për shkak të dorëheqjes së anëtarëve, ankesa e IAL nuk u shqyrtua. Për rrjedhojë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e datës 16.09.2019, njoftoi të gjitha IAL që kishin ushtruar ankesa, që të realizonin të drejtën e tyre nëpërmjet gjykatës kompetente.

Veprimet procedurale të Gjykatës;

Kolegji Iliria ka parashtruar padi kundër vendimit të KShC-së Ref.1365/19D datë 29.07.2019 në Gjykatën Themelore Departamenti për çështje Administrative në Prishtinë me datë 03.10.2019 në kurse pas themelimit të Gjykatës Komerciale, lënda ishte bartur në Gjykatën Komerciale Dhoma e shkallës së parë, me pretendimet se vendimi ishte i kundërligjshëm dhe se organi vendimmarrës kishte shkelur ligjin në pikat si në vijim:

- Duke mos shqyrtuar ankesën e Kolegjit, në mungesë të Komisionit të Ankesave të AKA-së;
- Duke mos i dhënë kohën e mjaftueshme për dhënien e komenteve në draft raportin e dorëzuar nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë;
- Duke angazhuar ekspert ndërkombëtare që nuk i plotësonin kriteret e përcaktuara me Udhëzim Administrativ MASHT Nr.15/2018, duke pretenduar se e njëjta nuk ka përvojë në mësimdhënie dhe kurikula;
- Duke mos i dhënë kohën e mjaftueshme për t'iu përshtatur ndryshimeve ligjore konkretisht Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.15/2018 për Akreditimin e IAL-ve;
- Ndryshimin e agjendës nga ana ekspertëve gjatë ditës së vizitës për vlerësim.

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë KA.nr.280/22, datë 22.02.2024, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendos që çështja ti kthehet në rivendosje organit administrativ – KSHC-së, me vërejtjen për të evituar të metat procedurale të gjetura dhe evidentuara nga gjykata, që kishin ndodhur gjatë procesit të riakreditimit të Kolegjit Iliria. Gjykata konstatoi shkelje procedurale, duke i pranuar si të bazuara plotësisht pretendimet e parashtruara nga pala paditëse, përfshirë:

- *Mungesën e shqyrtimit të ankesës së Kolegjit, për shkak të mosfunksionimit të Komisionit të Ankesave të AKA-së;*
- *Mos përmbushjen e detyrimit për të ofruar kohë të mjaftueshme për komentimin e draft - raportit të ekspertëve;*
- *Mos përmbushjen e detyrimit për të dhënë një afat të arsyeshëm për përshtatjen me ndryshimet ligjore, veçanërisht Udhëzimin Administrativ MASHT Nr. 15/2018 për Akreditimin e IAL-ve.*

Gjykata kishte pranuar pjesërisht edhe pretendimin e paditësit për angazhimin e eksperteve ndërkombëtar në të cilin ka konstatuar se gjatë procesit të angazhimit të ekspertëve dy nga kriteret e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ MASHT Nr.15/2018 për Akreditimin, ishin bashkuar/shkrirë në vetëm një kriter (*Përvojë mësimore ose përvojë kërkimore shkencore/studimore*). Kurse për pretendimet tjera i kishte **konsideruar si jo relevante për lëndën dhe procedurën.**

AKA e pakënaqur me Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë KA.nr.280/22, datë 22.02.2024, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Gjykatën Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë Departamenti për Çështje Administrative, e cila pas shqyrtimit të ankesës, ka lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë me Aktgjykimin K.Dh.SH.II.nr.1069/24 datë 04.09.2024.

II. Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

- **Veprimet procedurale të AKA-së pas pranimit të Aktgjykimit;**

Pas pranimit të aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë K.Dh.SH.II.nr.1069/24 të datës 04.09.2024, protokolluar në AKA me Nr.prot.1879/24 datë 25.09.2024, AKA organizoi takime të brendshme me të gjitha Divizionet nga të dy Departamente e AKA-së, me qëllim shqyrtimin e aktgjykimit, diskutimin e gjetjeve të shkeljeve të evidentuara nga Gjykata Komerciale dhe gjetjen e modaliteteve për zbatimin e këtij aktgjykimi.

Pas analizimit të aktgjykimit KA.nr.280/22, datë 22.02.2024, AKA ka ardhur në përfundimin se bazuar në gjetjet e gjykatës dhe vërejtjet e dhëna nga gjykata në paragrafin 52 të aktgjykimit në të cilin thuhet, citim: “...në procedurë të rishqyrtimit obligohet e paditura, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konflikte Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe t'i mënjanojnë të metat e vendimit kontestues,

në atë mënyrë që ti trajtoj dhe ti arsyetoj kundërshtimet e paditësit në procedurën e vlerësimit lidhur me ri-akreditimin institucional dhe pretendimet, siç parashihet me dispozitat ligjore të dhëna në këtë aktgjykim.”

Nga sa u tha më lartë, AKA përcaktohet se mënyra e veprimit procedural në zbatim të Aktgjykimit është si në vijim:

1. AKA konsideron se çështja administrative duhet të kthehet në pikën ku është konstatuar shkelja procedurale nga gjykata, që nënkupton dërgimin e draft-raportit të ekspertëve në Kolegjin Iliria për dhënien e komenteve lidhur me draft dhe të vazhdohet tutje me procedurën e shqyrtimit të mëtutjeshëm.
2. Pas dorëzimit të draft raportit të eksperteve ndërkombëtar të vlerësimit, konform procedurave dhe dispozitave ligjore në fuqi, Kolegji Iliria do të duhej të dërgoj komentet tek AKA brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv (dy javë) dhe raporti të kthehet ekspertëve për plotësim sipas komenteve. Kolegji Iliria pas kishte pranuar draftin raportin e dërguar nga AKA kishte kthyer një shkresë në të cilën kishte shprehur disa pakënaqësi në proces dhe nuk i është përmbajtur rregullave përcaktuara me Udhëzimin administrativ Nr.15/2018, nenin 17, paragrafi 5. *”AKA e dërgon draftraportin e vlerësimit tek institucioni, Institucioni ka të drejtë të dorëzojë komente me shkrim mbi raportin fillestar të vlerësuesve të jashtë. Komentet mund të mbulojnë çfarëdo informacioni faktik të përfshirë në raport, por jo në rekomandimet e dhëna nga vlerësuesit e jashtëm. Komentet duhet të dorëzohen në AKA, më së largu brenda dy (2) javësh pas pranimi të draftraportit.”*, tutje sipas paragrafit 6. *”Ekipi i vlerësuesve të jashtëm mund të përmirësojë draftraportin duke u bazuar në komentet e dorëzuara nga institucioni. Nëse institucioni ka dorëzuar komente të qëndrueshme mbi gjendjen faktike, do ta dorëzojë Raportin përfundimtar në AKA, jo më vonë se katër (4) javë pas vizitës së bërë në terren.”*
3. AKA pas pranimi të komentet mbi draft raportin (edhe pse nuk ishin në harmoni me rregullat e përcaktuara më lartë paragrafët 5 dhe 6 të UA Nr.15/2018), ka proceduar komentet tek ekipi i ekspertëve.
4. Edhe pse kishte një shkoputje të gjatë kohore Ekipi i eksperteve ka pranuar dhe ka trajtuar komentet e Kolegjit Iliria lidhur me raportin e vitit 2019 për akreditim institucional dhe të programit. Pas pranimi të raportit final (shkresës) së dorëzuar nga ekipi i ekspertëve, stafi i AKA-së ka proceduar raportin për shqyrtim dhe vendimmarrje në KShC.
5. KShC gjatë shqyrtimit ka marr parasysh faktin se Kolegji Iliria nuk e kishte shfrytëzuar të drejtën e saj për të kundërshtuar ekipin e ekspertëve brenda afateve të përcaktuara me Udhëzimin administrativ Nr.15/2018, madje si dëshmi për këtë çështje ka gjetur emailin zyrtar të datës 17 Prill 2019 në të cilën Kolegji konfirmon agjendën e vizitës.
6. Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesve të Kolegjit Iliria lidhur me faktin se procesi duhet të kthehet në riaplikim (dorëzim të ri të aplikacionit), AKA konsideron se në aktgjykimin e gjykatës në asnjë pikë nuk është përmendur riaplikimi andaj dhe procesi është kthyer në rivlerësim të gjetjeve të evidentuara nga gjykata.

III. Ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim;

KShC konsideron se lista e ekspertëve si tërësi ishte e aprovuar nga organi kompetent (KShC) i cili ka diskrediton për të vendosur për çështjet profesionale të fushës specifike siç është arsimit i lartë. KShC është organi i vetëm në Republikën e Kosovës i mandatuar nga organi më i lartë ligjvënës dhe përfaqësues - Kuvendi i Republikës së Kosovës, që vlerëson proceset e akreditimit duke përfshirë edhe përzgjedhjen dhe angazhimin e ekspertëve ndërkombëtar.

IV. Bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

Vendimi i KShC-së është i bazuar në :

- Nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë);
- Nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011);
- Nenin 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016);
- Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) me theks të veçantë neni 4.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 147-të, të mbajtur më datë 23.03.2026, pas shqyrtimit të raportit përfundimtar të ekspertëve ndërkombëtarë dhe rekomandimeve të dhëna në raport, në bazë të kompetencave ligjore dhe vlerësimit të gjendjes faktike dhe juridike, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Iliria;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë